



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 257, Datë 09.09.2026

MBI

RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “YILDIRIM ENERGY EUROPE ALBANIA” SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16, 40, pika 2, gërma “ç” dhe 136, pika 2, të ligjit nr. 59/2026 “Për sektorin e energjisë elektrike”; neneve 4, pika 1, gërma “d”, 5, pika 1, gërma “d”, 13, 14 pika 9 dhe 16 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 09.09.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1923/12 prot., datë 08.09.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë “Yildirim Energy Europe Albania” sh.p.k. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

Konstatohet se:

- Shoqëria “Yildirim Energy Europe Albania” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 258, datë 21.12.2021, me afat vlefshmërie deri më 21.12.2026.
- Në momentin e licencimit, shoqëria është identifikuar me emrin “Albanian Energy Supplier 2” sh.p.k., emër i cili është ndryshuar më datë 28.09.2022 në “Yildirim Energy Europe Albania” sh.p.k., ndryshim i reflektuar edhe në vendimin e ERE-s nr. 68, datë 03.03.2023.
- Ajo ka paraqitur kërkesën për rinovimin e kësaj licence, me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 1923 prot., datë 22.06.2026, brenda afatit të përcaktuar në nenin 16, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” të ndryshuar.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 186, datë 06.07.2026, vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 07.07.2026 dhe 08.07.2026) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të

tretët (data 16.07.2026), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- ERE, me shkresën nr. 1923/3 prot., datë 15.07.2026, ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës, si dhe i ka bërë me dije informacionin/dokumentacionin që nevojitet të plotësohet në aplikim.
- Në kuadër të korrespondencës së zhvilluar me shoqërinë për plotësimin e aplikimit, ka rezultuar se ka ende dokumentacion që nevojitet të plotësohet, ndaj me qëllim për t'i dhënë më shumë kohë shoqërisë për të plotësuar këtë dokumentacion, bordi i ERE-s me vendimin nr. 225, datë 10.08.2026, vendosi të zgjasë me 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes në lidhje me kërkesën e shoqërisë për rinovimin e licencës. Ky vendim i është njoftuar shoqërisë me shkresën e ERE-s me nr. 1923/10 prot., datë 14.08.2026.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1923/11 prot., datë 21.08.2026, shoqëria ka depozituar dokumentacionin plotësues të aplikimit.
- Rezulton se shoqëria ka aktualisht një kontratë të vlefshme për disponimin e zyrave përfaqësuese të furnizuesit, por duke qenë se afati i saj përfundon më 01.02.2027 dhe nuk mbulon të gjithë periudhën 5-vjeçare të vlefshmërisë së licencës. Për sa më sipër, vlerësohet e nevojshme që shoqërisë t'i vendoset kushti që, brenda datës 01.02.2027, të depozitojë në ERE kontratën e përditësuar për përdorimin e zyrave ose dokumentacion tjetër që provon disponimin e ligjshëm të tyre për pjesën e mbetur të afatit të licencës.
- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të *“Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”* të ndryshuar, si dhe ka shlyer ndaj ERE-s të gjitha detyrimet për sa i përket pagesave të rregullimit.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të rinovojë licencën nr. 496, Seria F21, të shoqërisë “Yildirim Energy Europe Albania” sh.p.k., për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 258, datë 21.12.2021, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 22.12.2026.
2. Brenda datës 01.02.2027, shoqëria duhet të depozitojë në ERE kontratën e rinovuar të qirasë për përdorimin e zyrave përfaqësuese të furnizuesit ose dokumentacion tjetër që provon disponimin e ligjshëm të tyre për periudhën e mbetur të licencës.
3. Ky vendim është objekt rishikimi në rast të mosplotësimit të kushtit të vendosur në pikën 2 të këtij vendimi.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Originës të njoftojë shoqërinë “Yldirim Energy Europe Albania” sh.p.k., OST sh.a., OSSH sh.a. dhe ALPEX sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Paraqitja e ankimit nuk pezullon vlefshmërinë e vendimit, përveçse kur gjykata vendos ndryshe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI